

VENDIM
Nr. 75, datë 8.6.2015

**PËR MIRATIMIN E MODIFIKIMIT TË LICENCËS ME NR. 138, SERIA PV11K PËR
PRODHIMIN E ENERGJISË ELEKTRIKE NGA HEC-et E “PELLGUT TË
OKSHTUNIT”, ME FUQI TOTALE TË INSTALUAR 31.489 MW, TË SHOQËRISË
“DITEKO” SHPK, TË MIRATUAR ME VENDIMIN E BORDIT TË KOMISIONERËVE
TË ERE-s NR. 114, DATË 16.11.2011**

Në mbështetje të neneve 9 dhe 19, të ligjit nr. 9072, datë 22.5.2003, “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar; pikave 2.3 dhe 2.4, të licencës së prodhimit të energjisë elektrike nr. 138, seria PV11K; të neneve 13; 14, pika 2; 15, pikat 1, 2/b, 3 dhe 4; të rregullores “Për procedurat e licencimit, modifikimit, transferimit të plotë/të pjesshëm dhe rinovimit të licencave”, të miratuar me vendimin e Bordit të Komisionerëve nr. 108, datë 9.9.2008, Bordi i Komisionerëve i Entit Rregullator të Energjisë (ERE), në mbledhjen e tij të datës 8.6.2015, pasi lexoi relacionin e Drejtorisë së Licencimit dhe të Monitorimit të Tregut dhe Drejtorisë Juridike dhe të Mbrojtjes së Konsumatorit,

konstatoi se:

Aplikimi i shoqërisë “Diteko” sh.p.k., plotëson tërësisht kërkesat ligjore të parashikuara nga rregullorja “Për procedurat e licencimit, modifikimit, transferimit të plotë/të pjesshëm dhe rinovimit të licencave”, si më poshtë:

- Neni 15, pika 4, germa “a”: Informacioni me shkrim ku janë shpjeguar arsyet e kërkesës për modifikimin e licencës, i plotësuar në mënyrë korrekte.

Neni 15, pika 4, germa “b”: Është paraqitur vendimi me shkrim i organeve drejtuese të të licencuarit, të cilat shprehin vullnetin për të kërkuar modifikimin e licencës.

- Është paraqitur projekti i ri, i miratuar nga MEI, me shkresën nr. 131/8 prot., datë 8.7.2014, për një shfrytëzim optimal të prurjeve të lumit Zallë i Okshtunit, ku janë bërë disa ndryshime në skemën e shfrytëzimit të kaskadës, e cila tashmë përbëhet nga 7 HEC-e dhe jo nga 11 HEC-e.

Për gjithë sa më sipër cituar, Bordi i Komisionerëve i ERE-s

VENDOSI:

1. Modifikimin e licencës së shoqërisë “Diteko” sh.p.k., me nr. 138, seria PV11K, për prodhimin e energjisë elektrike nga HEC-et e “Pellgut të Okshtunit”, me fuqi totale të instaluar 31.489 MW, miratuar me vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s, nr. 141, datë 16.11.2011.

2. Fuqia e instaluar e HEC-eve të “Pellgut të Okshtunit”, nga 31.489 MW të bëhet 33.28 MW, sipas emërtimeve dhe fuqive si më poshtë: HEC “Borove”, me fuqi të instaluar 1.92 MW, HEC “Zabzun”, me fuqi të instaluar 0.3 MW, HEC “Sebisht + Prodan 1”, me fuqi të instaluar 3.8 MW, HEC “Prodan 2”, me fuqi të instaluar 1 MW, HEC “Okshtun Ekologjik”, me fuqi të instaluar 0.45 MW, HEC “Okshtun + Ternove + Lubalesh 1”, me fuqi të instaluar 14.95 MW dhe HEC “Lubalesh 2 + Gjorice”, me fuqi të instaluar 10.86 MW.

3. Ngarkohet Drejtoria e Licencimit dhe e Monitorimit të Tregut të njoftojë aplikuesin për vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
Petrit Ahmeti